



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 dhe Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-016/01-37429 të datës 22.07.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZATËN "QATAR CHARITY "

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **34,650.00 €** (tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro), Organizatës QATAR CHARITY", konform Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-016/01-37429 të datës 22.07.2025.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-016/01-37429 të datës 22.07.2025 dhe dispozitave të përcaktuara në Raportin specifikues të nënshkruar gjithashtu nga të njëjtat palë me datë 18.12.2025 për realizimin e projekteve për siguri ushqimore, konkretisht serra bujqësore dhe motokultivatorë me frezë kose, motokultivatorë me frezë kose dhe rimorkio që synojnë fuqizimin ekonomik të familjeve në nevojë , mbështetjen e sektorit bujqësor në territorin e Komunës së Lipjanit përmes ndarjes së granteve ku 80% nga vlera e projektit do të bashkëfinancohet

Organizata "QATAR CHARITY" ndërsa 20% do të bashkëfinancohet nga Komuna e Lipjanit.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2026 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-15243

Lipjan, më 31.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi



*Daut Azemi*